



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. _____ prot.

Belsh më: 14. 09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *“Materiale për ndricimin e qytetit për rastin e festive të fundvitit”.*

Kodipërkates në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): *Llamba-31521000-4, Drita për pemën e krishtlindjeve- 31522000-1, Pema e krishtlindjeve- 39298910-9.*

Vlera e fondit limit: *: 4 158 000(katër milion e njëqind e pesëdhjetë e tete mije) lekë pa TVSH .*

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike ,kriteret e veçanta të kualifikimit është kryer nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit nr, 1879 prot., datë 16.062026 ,referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 te VKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, që përcakton “ **cmimet e botuara nga instituti i statistikave (INSTAT) ,ose /dhe te tjera zyrtare ,të njohura nga institucionet perkatese ,(si,pershëmbull ,nga organet tatimore dhe doganore, dhomat e tregtisë , në manuale etj.**

Ne bazë t ë nenit 21 ,pika2 ,neni 35 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ,neni 2, ,pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, tëVKMnr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,autoriteti/enti kontraktorBashkia Belsh ka hartuar proceverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurë e sipërcituar, me përmbajtje si më poshtë :

Hartimi i dokumentave të tenderit u bë në përputhje me **ligjin Nr,162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurim Publik”** i ndryshuar si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar, ne te cileneshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa*

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimi e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cileneshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve të bëra në shtojcës 8) të DST-ve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtari profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët të regjistrohen në një nga regjistrat profesional ose tregtar.”

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë të Vendimit të Ministrave me Nr.285, datë 19.05.2025 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallërat ose shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund të ofrojnë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: Referuar ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta “operatorët ekonomik të cilët nuk kanë detyrimin ligjor të licencohen nga QKB-ja, duhet të paraqesin Ekstraktin Tregëtar, të cilët në fushën e veprimtarisë duhet të kenë të përfshirë objektin e prokurimit.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale si më lartëduke qënë se këto kriteret janë të detyrueshme, janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, kualifikimeve dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomik në lidhje me garantimin e zbatimit në veprimtarinë e tyre të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023-2024-2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshar me ligjin Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshimet në ligjin nr. 162/2020” Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar, citojmë : 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në : **b) gjëndjen ekonomike finaciare;...3.**Në lidhje me situatën ekonomike finaciare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe finaciari për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim Autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë nëvecanti që operatorët ekonomik të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomik të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit . Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomik nuk mund të tejkaloj dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.” **Në nenin “Kërkesat për kapacitet ekonomik-financiartë vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se , citojmë : “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet finaciare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori për një periudhë maksimumi deri në 1(tre) vite e fundit finaciare.” Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” i ndryshuar Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, VKM nr.922 datë 29.12.2017 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike “, autoriteti kontraktorgjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet.**

- 2.2.2** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore këstet e maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin ”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistimin e taksave vendore” I ndryshuar.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranebashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Njësia e prokurimit përcaktoi kritere që janë nëpërpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonëkontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, për kontratat e mallrave, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55 pika 4/b), tëVKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojëshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshmetë ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit , qëështë brenda vlerës kufi të përcaktuar nënenin e sipërcituar.Përcaktimi I vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore së sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës qëprokurohet.Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjëndjesdhëe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, tëcilët , nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnëpërvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

Përvoja e mëparshmeështë një element I domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik mbi bazë të vlerave të kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitet për të zbatuar kontraten me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një Bashkim operatorësh ekonomik sipas pikës 2 dhe 3 , të nenit 14 të LPP-së ku njëri prej të cilëve I përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhje, edhe gjatë zbatimit tëkontratës.Në duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar nëpërmjet palëve.

Ne nenin 55 “PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR” pika 4/b të vendimit të këshillit të ministrave me NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë :4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm .Lidhur me kërkesat për përvojat e ngjashme , vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara do të jetë: b)Për kontratat e mallëravedhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është e realizuar gjatë tri viteve të fundit , nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal I kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për tu vendosur në DST . Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë detyruese, dhe sitë tilla duhet të vendosen në DST-në e Prokurimit me objektin e mësipërme.

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë te punësuar mesatarisht të paktën **8 (tete) punonjës** për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar ,ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listepagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin ”.

Argumentimi:

Kërkesa për disponimin e një fuqie punëtore mesatare prej të paktën 8 (tetë) punonjësish përcaktohet në mbështetje të **nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë.**

Në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, Autoriteti Kontraktor ka mbajtur në konsideratë natyrën, kompleksitetin, mënyrën e realizimit dhe kërkesat teknike të objektit të prokurimit, duke u bazuar në parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës, konkurrencës dhe proporcionalitetit.

Gjithashtu, në zbatim të **nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020**, Autoriteti Kontraktor mund të vendosë kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike, si dhe aftësitë profesionale të nevojshme për zbatimin e kontratës sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Ligji përcakton gjithashtu se aftësia profesionale vlerësohet, ndër të tjera, në lidhje me personelin e nevojshëm për zbatimin e kontratës.

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe mënyrën e realizimit të kontratës, e cila nuk konsiston vetëm në furnizimin e mallrave, por përfshin edhe **transportin, montimin dhe vendosjen e elementeve dekorative, përfshirë elemente që vendosen në lartësi dhe montimin e pemës së Krishtlindjes**. Numri prej 8 punonjësish është përcaktuar në raport me organizimin minimal të nevojshëm të ekipit të punës për realizimin e kontratës, konkretisht: 2 elektrikistë, 2 punonjës për punime në lartësi, 1 shofer/operator i pajisjes ngritëse dhe 3 punonjës ndihmës.

Kërkesa synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin njerëzor të nevojshëm për të realizuar në mënyrë të njëkohshme dhe të sigurt furnizimin, montimin dhe vendosjen e elementeve dekorative brenda afatit të kontratës.

Për realizimin e objektit kërkohet një organizim i posaçëm i punës, pasi pjesa e montimit nuk mund të realizohet vetëm nga një ose disa punonjës të pakualifikuar dhe kërkon angazhimin e një ekipi të përbërë nga personel me funksione të ndryshme

Përcaktimi i këtij kriteri është bërë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi numri i kërkuar lidhet drejtpërdrejt me fuqinë punëtore minimale të nevojshme për realizimin e detyrimeve kontraktore dhe nuk kërkon një kapacitet njerëzor më të madh se ai i nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit.

2.3.3 – Operatori/ret ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë, pranë Autoritetit Kontraktor, mostrat e mallrave/elementeve të përcaktuara në tabelën e mëposhtme, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike.

Konkretisht:

Nr. Emërtimi i elementit	Njësia	Mostra
1 Drita LED me Varg me Shumë Funksione 7795cm	_____	1 mostër
2 Drita LED me Varg të Lidhshme 3815cm	_____	1 mostër
3 Drita LED me Kabëll Gomë & Izolim me Ngjitës 1160cm	_____	1 mostër
4 Rolo Tub LED me Flash & Mbrojtje UV 50cm	_____	1 mostër
5 Rolo LED Neon & Aksesore 50 cm	_____	1 mostër
5 Aksesore për Tuba Ndriçues/ Adaptor 20w 1pin	_____	1 mostër

- Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin mostrat e mallrave/elementeve të përcaktuara në tabelën e mësipërme, pranë Autoritetit Kontraktor, **në datën 25.09.2026, nga ora 09:00 deri në orën 10:00.**

Argumentimi :

Kërkesa për paraqitjen e mostrave përcaktohet në mbështetje të **nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar**, si dhe **nenit 40, pika 6, shkronja “a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar**, i cili parashikon mundësinë e kërimit të mostrave të mallit kur Autoriteti Kontraktor e gjykon se ato kanë rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike dhe në zbatim të **Udhëzimit nr. 03, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.**

Në përputhje me **pikën 1 të Udhëzimit nr. 03, datë 12.04.2022**, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë dorëzimin e mostrave të mallit objekt prokurimi, kur gjykon se paraqitja e tyre është e rëndësishme për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës. I njëjti Udhëzim përcakton se Autoriteti Kontraktor duhet të **argumentojë teknikisht vendosjen e kriterit për paraqitjen e mostrave**, dhe ky argumentim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, i cili publikohet së bashku me dokumentet e tenderit në SPE.

Në rastin konkret, paraqitja e mostrave është e nevojshme për të mundësuar **verifikimin fizik dhe objektiv të përputhshmërisë së mallrave të ofruara me kërkesat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike**, veçanërisht për sa i përket karakteristikave të ndriçimit, materialeve, elementeve të lidhjes, izolimit, mbrojtjes dhe karakteristikave të tjera teknike të kërkuara. Kërkesa për mostra lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe nuk vendoset si kërkesë formale, por si mjet verifikimi teknik për të garantuar që malli që do të furnizohet përputhet me kërkesat minimale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Paraqitja e mostrave i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë në mënyrë **fizike, objektive dhe të drejtpërdrejtë** përputhshmërinë e produktit të ofruar me kërkesat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike.

Mostrat janë kufizuar vetëm në elementet për të cilat verifikimi fizik është i nevojshëm dhe i dobishëm për vlerësimin e përputhshmërisë teknike dhe nuk kërkohet paraqitja e mostrave për

çdo artikull të kontratës. Procedura e dorëzimit, administrimit dhe kthimit të mostrave do të përcaktohet në përputhje me nenin 40, pika 6, shkronja “a”, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur me objektin e kontratës, është teknikisht i justifikuar dhe proporcional me qëllimin e verifikimit të cilësisë dhe përputhshmërisë së mallrave.

2.3.4 – Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin e nevojshëm për realizimin e montimit dhe vendosjes së mallrave, sipas kërkesave të specifikimeve teknike, konkretisht:

- 2(dy) elektrikist;
- 2 (dy) punonjës për punime në lartësi;
- 1 (një) shofer/ operator për përdorimin e pajisjes ngritëse, kur kërkohet nga mënyra e realizimit të montimit.
- 3(tre) punonjës ndihmes

a) Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma ose certifikate, Kontrata e punës , eshmipërkateseleshuarngainstitucione te akredituarangaautoritetetpergjegjeseshteterore, dëshmikualifikimi te sigurimitteknik (të vlefshme) lëshuarngaInspektoriatitShtetëror Teknik dhe Industrial apo ngasubjektejuridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. **Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë, ata mund të disponohen nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit.**

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi :

Kërkesa për disponimin e personelit të nevojshëm për montimin dhe vendosjen e mallrave përcaktohet në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, në lidhje me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, i cili i jep Autoritetit Kontraktor të drejtën të kërkojë burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike për zbatimin e kontratës.

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin jo vetëm furnizimin, por edhe transportin, montimin dhe vendosjen e elementeve dekorative, përfshirë elemente që vendosen në lartësi, realizimi i kontratës kërkon disponimin e personelit me aftësi dhe funksione të ndryshme teknike.

Konkretisht, kërkesa për: 2 elektrikistë; 2 punonjës për punime në lartësi; 1 shofer/operator të pajisjes ngritëse, 3 punonjës ndihmës, është përcaktuar në përputhje me organizimin e punimeve dhe me nevojën për realizimin e tyre në mënyrë të sigurt, të koordinuar dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Dy elektrikistët kërkohen për realizimin e lidhjeve, instalimit dhe kontrollit të elementeve ndriçuese te pemes dhe për garantimin e realizimit të punimeve elektrike në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë.

Dy punonjësit për punime në lartësi janë të nevojshëm për montimin dhe vendosjen e elementeve dekorative pemes në lartësi, duke mundësuar realizimin e punimeve në mënyrë të koordinuar dhe të sigurt.

Shoferi/operatori kërkohet kur mënyra e realizimit të punimeve kërkon përdorimin e pajisjes ngritëse dhe është i nevojshëm për operimin e sigurt të saj.

Tre punonjësit ndihmës janë të nevojshëm për transportimin, pozicionimin, mbajtjen, përgatitjen dhe asistimin gjatë montimit të elementeve dekorative dhe të pemës së Krishtlindjes dhe gjetheve dekoruese.

Përcaktimi i këtyre kategorive të personelit është bërë mbi bazën e **funksioneve konkrete që duhet të kryhen gjatë zbatimit të kontratës** dhe jo mbi bazën e një kërkesë të përgjithshme për staf.

Kërkesa për kualifikimin përkatës të personelit bëhet vetëm në ato raste kur ky kualifikim kërkohet nga natyra e detyrës ose nga legjislacioni përkatës dhe synon garantimin e realizimit të punimeve sipas kërkesave teknike dhe të sigurisë. Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon verifikimin e kapacitetit real të operatorit ekonomik për realizimin e pjesës së montimit dhe vendosjes.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon ose mund t'i vihet në dispozicion mjeti/pajisja ngritëse e nevojshme për montimin dhe vendosjen e pemës së Krishtlindjes dhe elementeve dekorative në lartësi, konkretisht:

- 1 (një) autovinç/pajisje ngritëse, me kapacitet dhe lartësi pune të përshtatshme për realizimin e montimit sipas specifikimeve teknike.
- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ”përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi :

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë ose t'i vihet në dispozicion një mjet/pajisje ngritëse përcaktohet në mbështetje të **nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar**, si dhe të **nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar**, në lidhje me burimet teknike të nevojshme për zbatimin e kontratës.

Pajisja ngritëse është e nevojshme për shkak se objekti i kontratës përfshin montimin dhe vendosjen e pemës së Krishtlindjes dhe elementeve dekorative në lartësi.

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi realizimi i kontratës përfshin montimin dhe vendosjen e pemës së Krishtlindjes dhe elementeve dekorative në lartësi, për realizimin e të cilave kërkohet përdorimi i një pajisjeje ngritëse të përshtatshme.

Autoriteti Kontraktor nuk kërkon që mjeti të jetë domosdoshmërisht në pronësi të operatorit ekonomik, por lejon që ai të disponohet nëpërmjet pronësisë, qirasë ose mënyrave të tjera të ligjshme të vënies në dispozicion. Në këtë mënyrë garantohet konkurrenca dhe proporcionaliteti i kriterit, duke u kërkuar vetëm disponimi faktik i pajisjes gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesa për dokumentacionin e mjetit synon verifikimin e ekzistencës, identifikimit dhe vlefshmërisë së tij, si dhe garantimin se pajisja e deklaruar është e përshtatshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Për rrjedhojë, kriteri është teknikisht i nevojshëm, i lidhur me objektin dhe proporcional me kërkesat për realizimin e kontratës.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin, transportin, montimin dhe vendosjen e mallrave objekt të prokurimit, sipas sasive, specifikimeve teknike dhe afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe kontratë.

Argumentimi :

Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë marrjen përsipër të furnizimit, transportit, montimit dhe vendosjes së mallrave përcaktohet në funksion të përcaktimit të qartë të detyrimeve që rrjedhin nga objekti i prokurimit.

Objekti i kontratës nuk kufizohet vetëm në furnizimin e mallrave, por përfshin edhe transportin, montimin dhe vendosjen e tyre sipas specifikimeve teknike. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të angazhohet për realizimin e plotë të të gjitha veprimeve të nevojshme për dorëzimin dhe vendosjen e mallrave në destinacion.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin dhe kushtet e realizimit të kontratës dhe synon të garantojë qartësinë e detyrimeve kontraktore të operatorit ekonomik.

II. Argumentimi specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga : Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit, kriterëve të vecanta” mbështetur ne VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, në varësi të objektit të kontratës përcjell me procesverbalin _____Prot., datë _____.2026 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike krijuar me urdhërin Nr. _____Prot., datë _____. Ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi dhe kriteret e vecanta te kualifikimit , duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 te LPP dhe neni 40 pika 2 e Vendimit e Keshillit te Ministrave nr.285/2021 “Per miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar , njesia prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallra objekt prokurimi.

Specifikimet teknike të hartuara për mallra objekt prokurimi, përshkruajnë elementet me të rendesishëm përbërës , që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 4 , pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 2 e VKM nr.285, date 19.05.2021”Per miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar cdokërkesë funksionale ose performance, dhe cdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.

NJËSIA E PROKURIMIT: